

ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË
ORGANIZATËN PËR SIGURI DHE
BASHKËPUNIM NË EVROPË (OSBE):
PROCEDURAT DHE PERSPEKTIVAT



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja I · 59 A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM:

ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË
ORGANIZATËN PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM
NË EVROPË (OSBE): PROCEDURAT DHE
PERSPEKTIVAT

Nëntor 2019

STUDIM:

ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË
ORGANIZATËN PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË
EVROPË (OSBE): PROCEDURAT DHE PERSPEKTIVAT

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Nëntor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
I. Hyrje.....	1
II. Prapavija: Procesi i Helsinkit – nga KSBE në OSBE.....	3
III. Arsyet për aplikim për anëtarësim në OSBE.....	6
IV. Procesi i anëtarësimit dhe mekanizmat institucional të OSBE-së.....	8
V. Sfidat: Ndërtimi i konsensusit.....	10
VI. Përvojat e anëtarësimit të shteteve regjionale.....	11
VII. Rëndësia dhe efektet e marrëveshjes finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në anëtarësimin në OSBE.....	16
VIII. Përfundimet.....	17
IX. Rekomandime	19

Shkurtesat

FIFA	Federata Ndërkombëtare e Shoqatës së Futbollit
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
KS	Këshilli i Sigurimit
KSBE	Komisioni për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UEFA	Unioni i Shoqatave Evropiane të Futbollit
UNESCO	Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara

I. Hyrje

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, politika e jashtme e Kosovës është orientuar në dy drejtime reciprokisht përfshirëse. E para, të pranojë sa më shumë njohje të pavarësisë së saj nga shtetet e tjera, ndërsa e dyta, të bëhet anëtare e sa më shumë organizatave dhe iniciativave rajonale dhe ndërkombëtare. Deri më tani, Kosova ka arritur sukses kryesisht në frontin e parë, duke u njohur nga 116 vende anëtare të OKB-së, ndërsa nuk ka qenë aq e suksesshme në frontin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare ndërqeveritare, me vetëm një numër të vogël anëtarësimesh ose aplikimesh.¹ Kosova është bërë pjesë e disa organizatave të mëdha ndërkombëtare, kryesisht atyre financiare, sikurse janë Grupi i Bankës Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe atyre sportive, sikurse janë Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, FIFA dhe UEFA, ndërsa nuk ka aplikuar për anëtarësim e as nuk është bërë anëtare e organizatave të mëdha rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut ose Kombet e Bashkuara.

Kosova më së shumti ka përdorur një qasje të “testimit të ujërave” me aplikimet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, të tilla si aplikimi dhe përpjekja për anëtarësim në Agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, si UNESCO, Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale (INTERPOL), dhe organizata të shkallës më të vogël, si një mjet për të provuar mbështetjen e shteteve që tashmë kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe mbështetjen e përgjithshme të bashkësisë ndërkombëtare në lejimin e Kosovës që të bëhet anëtare e plotë e bashkësisë ndërkombëtare. Për fat të keq për

¹ Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës (2019), ‘Lista e Njohjeve’. E disponueshme: <http://www.mfa-ks.net/subdomain/oldwebsite/?page=1,259> [Qasur më: 15 tetor 2019].

Kosovën, ajo nuk arriti të bëhet anëtare e UNESCO-s në vitin 2015², dhe e INTERPOL-it në vitin 2018³.

Mosarritja për t'u bërë anëtare e UNESCO-s dhe INTERPOL-it, nuk duhet ta zmbarsë Kosovën në përpjekjet e saj për t'u bërë anëtare e organizatave ndërkombëtare. Ka disa organizata të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare në të cilat Kosova do të mund të aplikonte për anëtarësim dhe përfundimisht të bëhet anëtare në to. Një organizatë e tillë është Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), e cila është prezente dhe ka mandat në Kosovë që nga viti 1999.⁴ Megjithëse misioni i OSBE-së në Kosovë bazohet në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe vendimin e Këshillit të Përhershëm të OSBE-së Nr. 305 të vitit 1999, objektivat që dalin nga këto dokumente tashmë janë arritur kryesisht dhe OSBE do të mund të vazhdojë mandatin dhe prezencën e saj në Kosovë në mënyrë më efektive pas anëtarësimit të Kosovës në OSBE.

Ky studim shqyrton rastin për aplikimin dhe anëtarësimin eventual të Kosovës në OSBE, duke prezantuar dhe analizuar fillimisht origjinën dhe ardhjen në jetë të OSBE-së nga dokumenti i saj themelues, Akti Final i Helsinkit, deri në OSBE-në e sotme. Pas prapavijës dhe kontekstit, do të analizohen arsyet apo motivet e ndryshme për aplikim dhe anëtarësim në OSBE. Së treti, ky studim do të analizojë dhe diskutojë në detaje procesin e anëtarësimit dhe mekanizmat e vendimmarrjes së OSBE-së dhe sfidat me të cilat do të përballet Kosova, siç është procedura e votimit me konsensus. Më tutje, studimi do të analizojë përvojat e anëtarësimit të ish vendeve të Jugosllavisë dhe të shteteve rajonale që janë anëtarësuar së fundmi në OSBE, si një metodë për të nxjerrur mësimet dhe përvoja që do t'i ndihmojnë rastit të Kosovës në këtë proces. Përfundimisht, ky studim do të diskutojë mundësinë e një marrëveshjeje ligjërish obligative në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe se si do të ndikonte kjo marrëveshjeje në lehtësimin e aplikimit dhe

² The Guardian (2016), 'Kosova dështon në përpjekjen për anëtarësim në UNESCO'. E disponueshme: <https://www.theguardian.com/world/2015/nov/09/kosovo-fails-in-unesco-membership-bid> [Qasur më: 15 tetor 2019].

³ Balkan Insight (2018), 'Kosova dështon të anëtarësohet në INTERPOL'. E disponueshme: <https://balkaninsight.com/2018/11/20/kosovo-s-bid-to-join-interpol-fails-11-20-2018/> [Qasur më: 15 tetor 2019].

⁴ OSBE (2017), 'Fakte mbi Misionin e OSBE-së në Kosovë'. E disponueshme: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/143996?download=true>. [Qasur më: 15 tetor 2019].

anëtarësimi të Kosovës në organizatat ndërkombëtare në përgjithësi, dhe OSBE-së në veçanti.

II. Prapavija: Procesi i Helsinkit – nga KSBE në OSBE

OSBE-ja u krijua nga një momentum që u përdor si duhet nga fuqitë kundërshtarë gjatë luftës së ftohtë. Ky momentum zakonisht referohet si *détente*, që u shfaq pas shmangies së Krizës së Raketave Kubane në 1962 midis SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik. Gjatë periudhës *détente*, qasja e fuqive kryesore ndaj njëri-tjetrit ndryshoj nga një lojë ku rezultati është zero në një lojë ku rezultati është pozitiv, që do të thotë palët do të krijojnë një zgjidhje në lidhje me sigurinë dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre, ku ose të gjithë fitojnë, ose askush nuk humb.⁵ Për atë qëllim, fuqitë kryesore dhe aleatët e tyre filluan një seri takimesh dhe samite të emërtuara si Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, më shumë të njohur si Procesi i Helsinkit në 1973, i cili kulminoi me aprovimin e Aktit Final të Konferencës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, i njohur si Akti Final i Helsinkit i vitit 1975.⁶ Akti Final i Helsinkit bëri thirrje për vazhdimin e takimeve dhe konferencave për t'i dhënë efekt dokumentit, duke shënuar kështu hapat e parë drejt institucionalizimit të KSBE-së⁷. Akti Final i Helsinkit krijoi tri fusha kryesore ku KSBE do të përqendrojë përpjekjet e saj për të garantuar siguri dhe bashkëpunim në Evropë. Fusha e parë merret me marrëdhëniet politike dhe ushtarake dhe masat që synojnë ndërtimin e besimit dhe sigurisë; së dyti, KSBE u përqendrua në bashkëpunimin ekonomik dhe mjedisor; dhe, së treti, shkëmbimin e kulturës, shkencës dhe teknologjisë dhe universalitetin e të drejtave të njeriut⁸. Për t'i dhënë efekt këtyre fokuseve të KSBE-së, Akti Final i Helsinkit përfshiu edhe Deklaratën mbi Parimet që Udhëheqin Marrëdhëniet midis Shteteve Pjesëmarrëse të cilat përmbajnë dhjetë parime të njohura edhe si “dekalog”⁹.

⁵ David J. Galbreth (2007), 'Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë' fq. 13.

⁶ KSBE (1975) 'Akti Final i Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Helsinki'. E disponueshme: <https://www.osce.org/helsinki-final-act?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

⁷ Po aty.

⁸ Po aty, fusnota 5.

⁹ Po aty, fusnota 6.

Nëpërmjet dhjetë parimeve të Aktit Final të Helsinkit, shtetet pjesëmarrëse morën përsipër që të respektojnë sovranitetin e njëri-tjetrit dhe të trajtojnë njëri-tjetrin në mënyrë të barabartë dhe të mos ndërhyjnë në punët e brendshme; të përmbahen nga kërcënimi ose përdorimi i forcës; të njohin paprekshmërinë e kufijve dhe të integritetit territorial të shteteve pjesëmarrëse; të angazhohen për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve; respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; të njohin të drejtat e barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve; të bashkëpunojnë mes vete dhe të përmbushin me mirëbesim detyrimet që dalin nga e drejta ndërkombëtare¹⁰.

Dhjetë parimet janë rezultat i një ekuilibri dhe kompromisi të bërë midis shteteve të Lindjes të përfaqësuar nga Bashkimi Sovjetik dhe aleatët e saj, dhe shteteve të Perëndimit të përfaqësuar nga SHBA dhe aleatët e saj, në lidhje me tre objektivat apo dimensionet e KSBE-së për sigurinë gjithëpërfshirëse dhe të përbashkët dhe bashkëpunimin në Evropë. Në takimet, samitet dhe konferencat që pasuan si rezultat i Aktit Final të Helsinkit, KSBE-ja u përqendrua në masat për t'i dhënë efekt Aktit Final të Helsinkit dhe në institucionalizimin e mëtejshëm të KSBE-së. Miratimi i Kartës së Parisit për Evropë të Re në vitin 1992, filloi krijimin e institucioneve të para të KSBE-së dhe transformimin pasues të KSBE-së në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) që njihet sot.

Karta e Parisit krijoi Këshillin e KSBE-së të përbërë nga Ministrat e Punëve të Jashtme të shteteve pjesëmarrëse që ishte përgjegjës, ndër të tjera, për të “marrë në konsideratë çështjet relevante të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe për të marrë vendimet e duhura.”¹¹ Më tej, u krijua Komiteti i Zyrtarëve të Lartë me mandate për të “përgatitur punën e Këshillit, për të zbatuar vendimet e tij, për të shqyrtuar çështjet aktuale dhe të marrë parasysh punën e ardhshme të KSBE-së, duke përfshirë marrëdhëniet e saj me forume të tjera ndërkombëtare.”¹² Karta e Parisit krijoi edhe Sekretariatit e KSBE-së i cili ishte përgjegjës për sigurimin e “mbështetjes administrative për mbledhjet e Këshillit dhe të Komitetit të Zyrtarëve të Lartë”, për të ruajtur arkivin e KSBE-së, dhe për të dhënë informacion për publikun dhe palët e interesuara.¹³ Karta e

¹⁰ Po aty.

¹¹ KSBE (1991), ‘Karta e Parisit për një Evropë të Re’ Shtëpia Botuese “8 Nëntori” [Qasur më: 15 tetor 2019].

¹² Po aty.

¹³ Po aty.

Parisit krijoi edhe dy institucione shtesë të KSBE-së, Qendrën e Parandalimit të Konfliktëve (QPK) duke u përqendruar në zvogëlimin e rrezikut të konfliktit; dhe, Zyrën për Zgjedhje të Lira e ngarkuar me përgjegjësi që të lehtësojë "kontaktet dhe shkëmbimin e informacionit për zgjedhjet brenda shteteve pjesëmarrëse".¹⁴

KSBE u shndërrua në OSBE-në e sotme në 1994 përmes Deklaratës së Samitit KSBE të Budapestit i cili theksonte se:

*KSBE është struktura e sigurisë që përqafton shtetet nga Vancouver në Vladivostok. Ne jemi të vendosur për t'i dhënë një shtysë të re politike KSBE-së, duke e bërë të mundur që ajo të luajë një rol të rëndësishëm në përmbushjen e sfidave të shekullit njëzet e një. Për të pasqyruar këtë përcaktim, KSBE tani e tutje do të njihet si Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).*¹⁵

OSBE-ja mbajti një samit në Stamboll në 1999 ku miratoi Dokumentin e Stambollit i cili përfshinte një numër dokumentesh të tjera, sikurse janë Karta për Sigurinë Evropiane; Deklarata e Samitit të Stambollit; Marrëveshja për Përshtatjen e Traktatit për Forcat e Armatosura Konvencionale në Evropë.¹⁶ Samiti i Stambollit diskutoi për krizën humanitare në Kosovë dhe rolin dhe mandatin e OSBE-së në përpjekjet për rindërtimin e Kosovës, pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.¹⁷

Përfshirja e OSBE-së në Kosovë filloi në 1992 përmes misionit të OSBE-së në Kosovë, Sanxhak dhe Vojvodinë që zgjati deri më 1993, dhe më vonë gjatë luftës së Kosovës në 1998 përmes Misionit të Verifikimit të OSBE-së të krijuar nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së.¹⁸ Task Forca e OSBE-së për Kosovën zëvendësoi Misionin e Verifikimit të OSBE-së për një periudhë të shkurtër midis qershorit dhe korrikut 1999, kur Këshilli i

¹⁴ Po aty.

¹⁵ KSBE (1994). Dokumenti i Budapestit, 'Drejt një Partneriteti të Vërtetë në një Erë të Re'. E disponueshme: <https://www.osce.org/mc/39554?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

¹⁶ OSBE (1999), 'Dokumentin e Stambollit'. E disponueshme: <https://www.osce.org/mc/39569?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty, fusnota 5.

Përhershëm themeloi Misionin e OSBE-së në Kosovë përmes Vendimit Nr. 305. Misioni i OSBE-së në Kosovë ose OMiK u krijua për të kontribuar në zbatimin e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së. Misioni i OSBE-së në Kosovë do të kishte, në veçanti, “rolin kryesor në çështjet që lidhen me ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë, si dhe të drejtat e njeriut.”¹⁹ Ky rol i OSBE-së do të përmbushej përmes ndërtimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore; përmes trajnimit të oficerëve të Policisë së Kosovës dhe operimit të Shkollës së Policisë së Kosovës, trajnimit të personelit gjyqësor dhe të shërbimit civil; demokratizimi dhe përmirësimi i qeverisjes përmes zhvillimit të organizatave të shoqërisë civile dhe partive politike; organizimi dhe mbikëqyrja e zgjedhjeve; monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut përmes, ndër të tjera, krijimin e institucionit të Ombudspersonit në Kosovë.²⁰

OSBE-ja sot përqendrohet më shumë në dy fusha shqetësuese: mbështetjen e demokracisë dhe zgjedhjeve të ndershme dhe ndërtimin e besimit në Kontinentin Evropian. Misioni i OSBE-së në Kosovë përfshin një numër aktivitete të përqendruara në të drejtat e njeriut; ndërtimin e kapaciteteve njerëzore; zgjedhjet; të drejtat e pakicave; lirinë e mediave dhe rininë.²¹ Deri më sot, OSBE ka 57 shtete pjesëmarrëse nga Evropa, Azia Qendrore dhe Amerika Veriore.²² OSBE-ja përfshin të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian dhe Republikat e Ish Bashkimit Sovjetik, SHBA-në dhe Kanadën, si dhe disa vende të tjera të Azisë Qendrore.

III. Arsyet për aplikim për anëtarësim në OSBE

Para se të ndalemi në procesin e anëtarësimit dhe procesin e vendimmarrjes brenda OSBE-së dhe sfidat që përcjellin këtë proces, në vijim do të shohim disa prej arsyeve pse duhet të aplikojë Kosova për anëtarësim në OSBE. Arsyet e *parë* dhe e vetëkuptueshme është për shkak të konsolidimit të pavarësisë së Kosovës edhe më tutje dhe integrimin e saj në bashkësinë ndërkombëtare. *Së dyti*, Kosova duhet të aplikojë për t’u bërë një shtet

¹⁹ OSBE (1999), ‘Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, Vendimi Nr. 305’. E disponueshme: <https://www.osce.org/pc/28795?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

²⁰ Po aty.

²¹ OSBE (2019), ‘Uebfaqja’. E disponueshme: <https://www.osce.org/> [Qasur më: 15 tetor 2019].

²² OSBE (2019). ‘Shtetet Pjesëmarrëse’. E disponueshme: <https://www.osce.org/participating-states> [Qasur më: 15 tetor 2019].

pjesëmarrës i OSBE-së me qëllim të kontributit në organizatën dhe misionin e saj. *Së treti*, Kosova duhet të aplikojë për t'u bërë shtet pjesëmarrës me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve kombëtare dhe për të përmbushur detyrimet që dalin nga Akti Final i Helsinkit dhe Karta e Parisit për Evropën e Re. Mëposhtë do të elaborojmë secilin argument veç e veç.

Pavarësia e Kosovës nuk është e plotë pa anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Fitimi i anëtarësimit në OSBE jo vetëm që konsolidon dhe konfirmon pavarësinë e Kosovës, por ç'është më e rëndësishmja e sjell Kosovën në tryezën e diskutimeve dhe bashkëpunimit në Evropë. Kosova nuk është në gjendje të luajë një rol aktiv në bashkësinë ndërkombëtare, përderisa zëri i saj nuk dëgjohej përmes përfaqësuesve të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli i Kosovës.

Së dyti, Kosova deri më sot ka qenë vetëm palë pranuese ose marrëse e përpjekjeve të organizatave ndërkombëtare për paqen dhe sigurinë në Kosovë. OSBE-ja ka kontribuar në Kosovë për më shumë se 20 vjet. Në veçanti, pasi Kosova përfundon tranzicionin e saj të kalimit drejt paqes dhe demokracisë së qëndrueshme, ajo mund të kontribuojë me përvojën e saj në vende të tjera pas-konfliktit. Në fakt, Kosova do të ishte një shembull i mirë i një procesi të suksesshëm të tranzicionit dhe rindërtimit pas konfliktit dhe e njëjta do të mund të shpërndante përvoja të vlefshme me vendet e tjera në situata të ngjashme. Kosova ka një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve, të përfaqëuar në Kushtetutën e saj.

Anëtarësimi në OSBE do të rris dhe forcojë edhe më tej nivelin e mbrojtjes, në veçanti të pakicave kombëtare të Kosovës. Në këtë drejtim, Kosova do të duhet të miratojë Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për një Evropë të Re, e cila përmban garanci për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e minoriteteve. Më të rëndësishme, sidoqoftë, janë mekanizmat për mbrojtjen dhe zbatimin efektiv të të drejtave të minoriteteve. Pas anëtarësimit në OSBE, Kosova do t'i nënshtrohej monitorimit nga ODIHR dhe Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare, i cili, në rast se Kosova nuk do t'i përmbushte angazhimet e saj politike ose detyrimet ndërkombëtare, do t'i ndihmonte Kosovës duke dhënë rekomandime dhe udhëzime për veprim.

IV. Procesi i anëtarësimit dhe mekanizmat institucional të OSBE-së

Institucionet kryesore dhe mekanizmat vendimmarrës të OSBE-së përfshijnë Kryesuesin në detyrë dhe sistemin Troika, ose kryesinë e kaluar, të tanishme dhe të ardhshme, të cilët sigurojnë memorie institucionale dhe ndihmojnë Kryesuesin në detyrë. Kryesuesi ka një mandat prej një viti. Mekanizëm tjetër është Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare i cili merret ekskluzivisht me çështjet e pakicave kombëtare. Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është e ngarkuar me detyrën për të punuar në çështjet që kanë të bëjnë me Dimensionin Njerëzor të Aktit Final të Helsinkit.

ODIHR është një organ autonom i OSBE-së që punon për demokratizimin, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, tolerancën dhe mos diskriminimin dhe zgjedhjet. ODIHR ushtron mandatin e saj kryesisht përmes misioneve në terren. Asambleja Parlamentare e OSBE-së përbëhet nga 323 parlamentarë nga shtetet pjesëmarrëse dhe shërben si një forum për diplomacinë dhe debatin parlamentar, dhe forcon bashkëpunimin ndërkombëtar për çështje politike, sigurie, ekonomike, mjedisore dhe të drejtave të njeriut. Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias i cili vëzhgon zhvillimet në fushën e mediave dhe ndihmon shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj lirisë së shprehjes dhe mediave. Sekretariati ofron mbështetje operacionale për organizatën dhe drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Dy institucione të tjera të OSBE-së përfshijnë Gjykatën e Pajtitimit dhe Arbitrazhit si dhe Grupin e Minskut të OSBE-së.

Mekanizmat e vendimmarrjes politike përfshijnë Këshillin e Ministrave, i cili përbëhet nga Ministrat e Jashtëm të shteteve pjesëmarrëse i cili mblidhet të paktën një herë në vit në vendin që aktualisht mban Kryesinë e OSBE-së. Këshilli i Ministrave është organi qendror vendimmarrës dhe drejtues i organizatës. Në periudhën e përkohshme midis mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Përhershëm është organi kryesor vendimmarrës për konsultime të rregullta politike dhe për qeverisjen e punës ditore operative të OSBE-së. Këshilli i Përhershëm zbaton vendimet e marra nga Samitet e OSBE-së në nivelin më të lartë dhe nga Këshilli i Ministrave. Këshilli i Përhershëm mblidhet një herë në javë në Vjenë dhe kryesohet nga Kryesuesi në detyrë i OSBE-së.

Këshilli i Përhershëm përbëhet nga delegatë nga 57 shtete pjesëmarrëse. Një mekanizëm tjetër institucional që merret kryesisht me sigurinë ushtarake dhe stabilitet është Forumi për Bashkëpunim për Sigurinë.

Procedurat e vendimmarrjes përcaktohen në Rregulloren e Procedurës së OSBE-së. Neni 1 i Rregullores së Procedurës parashikon që “të gjitha shtetet pjesëmarrëse në OSBE marrin pjesë si shtete sovrane, të pavarura dhe në kushte të barazisë së plotë.”²³ Neni II(A)2 parashikon që “vendimet e organeve vendimmarrëse të OSBE-së miratohet me konsensus. Konsensusi do të kuptohet se nënkupton mungesën e ndonjë kundërshtimi të shprehur nga një shtet pjesëmarrës për miratimin e vendimit në fjalë.”²⁴ Neni II (B)2 i Rregullores së Procedurave parashikon që “organi më i lartë vendimmarrës i OSBE-së është Takimi i Krerëve të Shteteve ose Qeverive (Samiti), i cili merr vendime, vendos prioritete dhe siguron orientim në nivelin më të lartë politik”²⁵. Organi i dytë më i lartë vendimmarrës është Këshilli i Ministrave i cili përbëhet nga ministrat e punëve të jashtme të shteteve pjesëmarrëse. Në nenin II(B)3 të Rregullores së Punës thuhet se Këshilli i Ministrave “është forumi qendror për konsultime politike brenda OSBE-së dhe mund të marrë në konsideratë dhe të marrë vendime për çdo çështje të rëndësishme për Organizatën.” Këshilli i Përhershëm është trupi vendim-marrës kryesor ndërmjet mbledhjeve të Këshillit të Ministrave për çështjet ditore të Organizatës.

Bazuar sa më sipër, rrjedhë se për pranimin e një shteti të ri pjesëmarrës në OSBE, siç është Kosova, një vendim duhet të merret nga Këshilli i Ministrave i përbërë nga ministrat e jashtëm të 57 shteteve pjesëmarrëse. Një vendim i tillë duhet të merret me konsensus, që do të thotë se asnjë shtet nuk duhet të kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në OSBE. Në vijim, do të analizojmë procedurën e votimit dhe nëse - në këtë moment kohor - është e mundur që Kosova të arrijë konsensus midis shteteve të ndryshme pjesëmarrëse të OSBE-së dhe të anëtarësohet si anëtare e plotë.

Rregullorja e Procedurës së OSBE-së nuk përcakton ndonjë kusht specifik përveç atyre që përmbahen në nenin I.1 që një shtet duhet të plotësojë për tu bërë shtet pjesëmarrës.

²³ OSBE (2006), ‘Rregullat e Procedurës të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë’. E disponueshme: <https://www.osce.org/mc/22775?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

Pra, shtetet pjesëmarrëse duhet të jenë shtete të pavarura dhe sovrane. Sidoqoftë, kushtet për pranimin në OSBE janë përcaktuar në praktikën e OSBE-së në pranimin e vendeve të reja pjesëmarrëse. Për të aplikuar për pranim në OSBE, Kosova para së gjithash duhet të miratojë Aktin Përfundimtar të Helsinkit, Kartën e Parisit për Evropën e Re dhe të gjitha dokumentet e tjera të miratuara nga KSBE dhe OSBE. Kjo mund të bëhet me një Deklaratë të paraqitur Kryesuesit në detyrë. Së dyti, Kosova duhet të deklarojë se i pranon të gjitha detyrimet dhe angazhimet e përfshira në dokumentet e mësipërme dhe se do të veprojë në përputhje me dispozitat e tyre.²⁶

Aplikimi i Kosovës ose letra e Ministrit të Jashtëm dërguar Kryesuesit në Detyrë do t'ju përcillet vendeve pjesëmarrëse dhe do të vihet në rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme të Këshillit të Ministrave për vendimmarrje. Këshilli i Ministrave mund të marrë një vendim në njërin nga dy mënyrat vijuese, përmes një konsensusi të arritur gjatë mbledhjes, që do të thotë se asnjë shtet nuk ka kundërshtuar miratimin e vendimit; ose, përmes një procedure të heshtur, me të cilën Kryesuesi qarkullon një projektvendim midis shteteve pjesëmarrëse së bashku me një periudhë të caktuar për çdo kundërshtim ndaj projektvendimit. Nëse gjatë procedurës së heshtjes nuk është pranuar asnjë vërejtje apo kundërshtim, vendimi konsiderohet se është miratuar, ndërsa, nga ana tjetër, nëse pranohet një kundërshtim gjatë procedurës së heshtjes, kjo nënkupton se vendimi nuk është miratuar.

Aktualisht është pothuajse pamundur që Kosova të sigurojë konsensus brenda OSBE-së, pasi të paktën dy shtete pjesëmarrëse do të kundërshtonin pranimin e Kosovës në OSBE. E para nga shtetet e tilla është Serbia, së bashku me aleatët e saj, si Rusia dhe disa ish-Republika Sovjetike.

V. Sfidat: Ndërtimi i konsensusit

Sikurse ilustruhet më lartë, vendimet në OSBE merren me konsensus të 57 shteteve pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se asnjë kundërshtim nuk duhet të ngrihet nga shtetet

²⁶ Shih p.sh., Mbledhja e parë e Këshillit, Përmbledhja e Përfundimeve, Deklarata e Shqipërisë (1991) fq.4. E disponueshme: <https://www.osce.org/mc/40234?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

pjesëmarrëse kur votojnë mbi kërkesën e Kosovës për anëtarësim. Arritja e konsensusit për pranimin e Kosovës në OSBE duket si mision i pamundur në këtë moment, veçanërisht duke marrë parasysh marrëdhëniet e acaruar me Serbinë dhe Bosnjë dhe Hercegovinën për shkak të tarifës 100% të aplikuar nga Kosova për importet nga këto vende. Grupi i dytë i shteteve që ka të ngjarë të kundërshtojnë kërkesën për pranim të Kosovës në OSBE janë vendet anëtare jo-njohëse të Bashkimit Evropian, në veçanti, Spanja dhe Rumania. Së treti, Rusia dhe një numër i ish Republikave Sovjetike ka të ngjarë të kundërshtojnë kërkesën e Kosovës, gjithashtu për shkak të aleancës së tyre me Rusinë dhe aleancës së kësaj të fundit me Serbinë.

Kosova duhet ta paraqesë rastin për anëtarësim në OSBE si të rëndësishëm për të drejtat e njeriut dhe Dimensionin Njerëzor të OSBE-së. Pranimi i Kosovës në OSBE do të thotë që Kosova do të marrë përsipër edhe më shumë detyrime ndaj qytetarëve të saj, në veçanti pakicave kombëtare, siç janë serbët, romët dhe ashkallitë dhe pakicat e tjera. Nga pranimi i Kosovës do të përfitonin në veçanti këto komunitete pasi ato do të fitonin mekanizma dhe forume të reja për të adresuar shqetësimet dhe ankesat e tyre për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave kombëtare.

Për më tepër, një argument tjetër që Kosova duhet të përdorë në ndërtimin e konsensusit duhet të jetë përdorimi i mekanizmave të OSBE-së dhe përvojës së saj në Kosovë për dialog ndëretnik midis të gjithë qytetarëve të Kosovës, veçanërisht midis shumicës shqiptare dhe pakicës serbe me qëllim të arritjes së paqes së qëndrueshme dhe pajtimit ndërmjet dy popujve. Më tutje, Kosova mund të shqyrtoj alternativën për një status të vëzhguesit në vend të pranimi të plotë si një anëtar i barabartë. Ky do të ishte hapi i parë drejt anëtarësimit të plotë më vonë.

VI. Përvojat e anëtarësimit të shteteve regjionale

KSBE u krijua në 1973 dhe shtetet pjesëmarrëse në atë kohë ishin shtetet kryesore evropiane, BRSS, Shtetet e Bashkuara dhe Kanada. Shqipëria u bashkua OSBE-së në 1991, ndërsa një numër i ish Republikave Sovjetike si dhe vende nga Azia Qendrore u bashkuan në OSBE në 1992. Maqedonia e Veriut iu bashkua OSBE-së në 1995 përmes një vendimi

të Këshillit të Përhershëm, në vend të Këshillit të Ministrave. Serbia iu bashkua OSBE-së në 2000, ndërsa Mali i Zi u anëtarësua në OSBE në 2006.

Në vijim do të shohim përvojat e këtyre vendeve dhe nëse Kosova mund të mësojë ndonjë gjë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në OSBE. Situata e Kosovës dhe raporti me OSBE-në është unik dhe i ndryshëm në krahasim me atë të vendeve të tjera. *Së pari* dhe më e rëndësishmja, Misioni dhe Mandati i OSBE-së në Kosovë bazohet në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila pavarësisht se nuk e përmend në mënyrë të veçantë OSBE-në, Vendimi nr. 305 i 1 korrikut 1999 i Këshillit të Përhershëm që themelon Misionin e OSBE-së në Kosovë i referohet Rezolutës së KS të OKB 1244. *Së dyti*, marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë janë unike dhe shumë të rëndësishme në kontekstin e pranimit të OSBE-së, duke marrë parasysh që Serbia nuk e njeh Kosovën dhe bën gjithçka është e mundur për të sabotuar dhe minuar ekzistencën e saj.

Duke pasur parasysh këtë kontekst, nuk ka gjasa që përvoja e vendeve të tjera të jetë e dobishme në rastin e Kosovës, me përjashtim të asaj të Maqedonisë së Veriut.

Shqipëria

Shqipëria është një nga vendet e para që iu bashkua KSBE-së nga rajoni, duke e bërë këtë në vitin 1991. Ministri i Punëve të Jashtme i Shqipërisë, z. Muhamet Kapllani i dërgoi një letër Kryesuesit në detyrë të KSBE-së, z. Hans-Dietrich Genscher, me anë të së cilës deklaroi se Qeveria e Shqipërisë miraton Aktin Final të Helsinkit, Kartën e Parisit për një Evropë të Re dhe të gjitha dokumentet e tjera të KSBE-së dhe se i pranon të gjitha detyrimet dhe angazhimet e përfshira në ato dokumente. Më tej, letra theksonte se Republika e Shqipërisë mirëpret një Mision monitorues për të raportuar mbi përparimin e arritur në Shqipëri drejtë përmbushjes së synimeve të KSBE-së.²⁷

Pas letrës së aplikimit nga Shqipëria, Ministrat e Jashtëm të shteteve pjesëmarrëse mirëpritën Shqipërinë si një shtet pjesëmarrës të KSBE-së gjatë Takimit në Berlin të

²⁷ KSBE (1991), 'Letra e Ministrit të Jashtëm të Shqipërisë drejtuar Kryesuesit në detyrë'. E disponueshme: <http://www.ambasadat.gov.al/osbe/en/node/246> [Qasur më: 15 tetor 2019].

Këshillit të KSBE-së, mbajtur më 19-20 qershor 1991.²⁸ Së fundi, Shqipëria do të jetë Kryesues i OSBE-së gjatë vitit 2020, duke filluar nga 1 Janar 2020, duke marrë përsipër këtë rol nga Sllovakia, në këtë rast Ministri i Jashtëm i Shqipërisë do të mbajë pozicionin e Kryesuesit në detyrë gjatë kryesimit të OSBE-së.²⁹

Kroacia dhe Sllovenia

Përvojat e anëtarësimit të Kroacisë dhe Sllovenisë mund të jenë me interes, por jo aq relevante për Kosovën. Kroacia, së bashku me Slloveninë, ishin vendet e para që shpallën pavarësinë nga Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë më 25 qershor 1991. Pas shpalljes së pavarësisë, Këshilli i Ministrave të Komunitetit Ekonomik Evropian themeloi Komisionin e Arbitrazhit të Konferencës për Jugosllavinë, i njohur si Komisioni i Badinterit i cili ofroi pesëmbëdhjetë (15) opinione për pyetje të ndryshme juridike në lidhje me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe njohjen pasuese të shteteve të reja. Opinioni 1 i Komisionit të Badinterit konfirmoi se Jugosllavia është në proces të shpërbërjes. Opinioni 7 rekomandoi njohjen e pavarësisë së Sllovenisë, ndërsa Opinioni 5 vendosi fillimisht që pavarësia e Kroacisë ende nuk duhet të njihet, sepse Kushtetuta e re Kroate nuk përfshin mbrojtjet për pakicat kombëtare siç kishte kërkuar Komuniteti Evropian. Pas kësaj, Presidenti i Kroacisë ofroi garanci se mangësitë do të korrigjohen dhe bazuar në këto deklaratime, Komuniteti Evropian njohu edhe Kroacinë.

Pas njohjes së pavarësisë së tyre nga Komuniteti Evropian dhe ndërsa Konferenca për Jugosllavinë ishte ende në vazhdim, Kroacia dhe Sllovenia aplikuan për anëtarësim në KSBE. Këshilli i KSBE-së i dha statusin e Vëzhguesit Kroacisë dhe Sllovenisë gjatë Takimit në Pragë të 30-31 Janarit 1992.³⁰ Dy muaj më vonë, gjatë Takimit të Parë shtesë të Këshillit të KSBE-së, më 24 mars 1992 Ministrat e Jashtëm pranuan Kroacinë dhe Slloveninë si shtete pjesëmarrëse. Përmbledhja e përfundimeve të Takimit të Parë shtesë

²⁸ KSBE (1991), 'Takimi i parë i Këshillit, Përmbledhje e Konkluzioneve, Deklaratë për Situatën në Jugosllavi'. E disponueshme: <https://www.osce.org/mc/40234?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

²⁹ OSBE (2019), 'Kryesia e OSBE-së e Shqipërisë të përqëndrohet në "Zbatimin e angazhimeve të OSBE-së", Ministri në detyrë për Evropë dhe Punë të Jashtme, Gent Cakaj, i thotë Këshillit të Përhershëm'. E disponueshme: <https://www.osce.org/chairmanship/425459> [Qasur më: 15 tetor 2019].

³⁰ KSBE (1992), 'Mbledhja e dytë e Këshillit, Përmbledhje e Konkluzioneve, Dokumenti i Pragës për zhvillimin e mëtutjeshëm të strukturave dhe institucioneve të KSBE-së'. E disponueshme: <https://www.osce.org/mc/40270?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

të Këshillit theksonte si vijon, “Ministrat mirëpritën Kroacinë, Gjeorgjinë dhe Slloveninë si Shtete pjesëmarrëse, pas pranimit të letrave me të cilat pranuan angazhimet dhe përgjegjësitë e KSBE-së nga secila prej tyre. Ministrat nuk konsiderojnë se pranimi i Kroacisë dhe Sllovenisë do të ndikojë në ndonjë mënyrë në Konferencën për Jugosllavinë dhe as nuk paragjykon rezultatet e kësaj konference. Ministrat mbështesin përpjekjet e Konferencës së Brukselit për Jugosllavinë në kërkim të një zgjidhjeje politike të përgjithshme të krizës Jugosllave.”

Konteksti në të cilin Kroacia dhe Sllovenia u bënë anëtare të KSBE-së ndryshon nga konteksti i sotëm në atë që KSBE nuk ishte e institucionalizuar në nivelin që OSBE është sot. Të dy shtetet, Kroacia dhe Sllovenia, ishin njohur tashmë nga të gjithë anëtarët e KSBE-së dhe nga bashkësia ndërkombëtare. Më tej, këto shtete dhe shtetet e tjera që synonin anëtarësimin në KSBE u detyruan të miratojnë dhe respektojnë Aktin Final të Helsinkit. OSBE sot është një organizatë ndërkombëtare plotësisht e institucionalizuar me institucione dhe mekanizma vendimmarrës që e vështirësojnë anëtarësimin e Kosovës përveç nëse pavarësia e saj njihet nga të gjithë anëtarët e OSBE-së.

Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina shpalli pavarësinë nga ish-Jugosllavia më 3 mars 1992, pas një referendumit të mbajtur midis 29 shkurtit dhe 1 marsit 1992.³¹ Bosnja dhe Hercegovina shpalli pavarësinë në mes të procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, pasi Kroacia dhe Sllovenia e kishin bërë këtë tashmë. Komuniteti serb brenda Bosnjës dhe Hercegovinës bojkotoi referendumin dhe rrjedhimisht shpalljen e pavarësisë, duke ndezur kështu konfliktin që do të definonte periudhën në mes të vitit 1992 dhe 1995 në Bosnjë dhe Hercegovinë. Pavarësia e Bosnjës dhe Hercegovinës u njoh pothuajse menjëherë nga Komuniteti Evropian, SHBA dhe shtetet e tjera. Bosnja dhe Hercegovina u bë shtet pjesëmarrës i KSBE-së më 29 Prill 1992 në një proces të shpejtë dhe ndryshe nga Kroacia dhe Sllovenia. Vendimi për të pranuar Bosnjë dhe Hercegovinën u mor nga Komiteti i atëhershëm i Zyrtarëve të Lartë dhe jo nga Këshilli i KSBE-së siç ishte rasti me Kroacinë

³¹ Helen Walasek (2015), ‘Bosnia dhe Shkatërrimi i Trashëgimisë Kulturore’, Shtëpia Botuese Ashgate, faqe 4. E disponueshme: https://www.google.com/books/edition/Bosnia_and_the_Destruction_of_Cultural_H/HeNxCAAQBAJ?hl=en&gbpv=1&printsec=frontcover [Qasur më: 15 tetor 2019].

dhe Slloveninë.³² Vendimi për të pranuar Bosnje dhe Hercegovinën duhej të konfirmohej në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të KSBE-së, por kjo nuk ndodhi. Përkundër kësaj, Bosnja dhe Hercegovina u anëtarësua në KSBE.³³

Maqedonia Veriore

Maqedonia e Veriut iu bashkua OSBE-së në vitin 1995, dy vjet pasi ishte bërë shtet vëzhgues brenda OSBE-së. Maqedonia e Veriut u antarësua përmes vendimit Nr. 81 të Këshillit të Përhershëm. Në të gjitha rastet e tjera, Këshilli i Ministrave ka vendosur për pranimin e shteteve të reja pjesëmarrëse, ndërsa në rastin e Maqedonisë Veriore ishte Këshilli i Përhershëm.³⁴ Greqia kishte shprehur shqetësime për emrin e Maqedonisë së Veriut në atë kohë. Në këtë mënyrë, Vendimi Nr. 81 u aprovua vetëm pasi që në të u vendos një referencë që theksonte se ky shtet pjesëmarrës “do të referohej përkohësisht për të gjitha qëllimet brenda OSBE-së si ‘ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë’”. Delegacioni Grek do të bënte gjithmonë deklaratat interpretuese duke rikujtuar këtë frazë në të gjitha dokumentet e aprovuara nga shtetet pjesëmarrëse pas pranimin të Maqedonisë Veriore.³⁵

Serbia

Serbia u bë anëtare e OSBE-së më 10 nëntor 2000, së pari si Republika Federale e Jugosllavisë, pastaj si Unioni Shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi, dhe së fundi si Republika e Serbisë që nga 29 qershor 2006.³⁶ Para anëtarësimit në OSBE në nëntor të vitit 2000, RFJ u pezullua nga OSBE në 12 maj 1992 me një vendim të Komitetit të Zyrtarëve të Lartë.³⁷ Vendimi për pezullimin u mor me një procedurë votimi që krijoi një precedent të njohur si “konsensusi minus një”, që do të thoshte se pëlqimi i RFJ-së për aprovimin e

³² Arie Bloed (1995), ‘Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë: Analizë dhe Dukementet Bazike, 1972-1993’, Shtëpia Botuese Akademike Kluwer, faqe. 109 [Qasur më: 15 tetor 2019].

³³ Po aty.

³⁴ OSBE (1995), ‘Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, Vendimi Nr. 81’. E disponueshme: <https://www.osce.org/pc/20341?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

³⁵ Shih p.sh., Dokumenti i Stambollit i 1999.

³⁶ OSBE (2006), ‘Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, Vendimi Nr. 733’. E disponueshme: <https://www.osce.org/pc/19697?download=true> [Qasur më: 15 tetor 2019].

³⁷ Valery Perry (1998), ‘Pezullimi i Republikës Federative të Jugosllavisë nga OSBE’. E disponueshme: https://www.cvce.eu/content/publication/2005/11/7/3766bd03-0e5c-4541-b4d6-5412e1489a76/publishable_en.pdf [Qasur më: 15 tetor 2019].

vendimit për pezullim nuk kërkohet.³⁸ Siç kemi parë më herët, të gjitha vendimet në OSBE merren me konsensus, kështu që organet e OSBE-së duhet të dilnin me një zgjidhje për të pezulluar RFJ-në. Vendimi për të pezulluar RFJ-në theksoi se “në funksion të shkeljeve të qarta, të ashpra dhe të pakorrigjuara të synimeve të KSBE-së, veprimi i duhur në lidhje me krizën, do të merret deri më 30 qershor në mungesë të pëlqimit të delegacionit të Jugosllavisë”.³⁹

RFJ u pranua në OSBE më 10 nëntor 2000. Gjatë Takimit të Tetë të Këshillit të Ministrave, OSBE miratoi Deklaratën e Vjenës për Rolin e OSBE-së në Evropën Jug-Lindore, e cila ofroi kornizën e Mandatit të ri të OSBE-së në rajon, duke përfshirë Kosovën. Anëtarësimi i RFJ-së dhe Serbisë në OSBE është e rëndësishme për Kosovën, duke marrë parasysh precedentin e krijuar për vendimmarrje përmes votimit “konsensusi minus një” bazuar në të cilin RFJ u pezullua nga OSBE. Një mekanizëm i ngjashëm votimi mund të përdoret për pranimin e Kosovës në OSBE në mungesë të pëlqimit të Serbisë, me kusht që Kosova të ketë arritur konsensus me shtetet e tjera pjesëmarrëse të OSBE-së.

VII. Rëndësia dhe efektet e marrëveshjes finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në anëtarësimin në OSBE

Kosova dhe Serbia ka të ngjarë të ri-fillojnë së shpejti një proces bisedimesh i cili duhet të çojë në një marrëveshje përfundimtare për dallimet e tyre në lidhje me pavarësinë e Kosovës. Për momentin, megjithatë, ekzistojnë disa pengesa kryesore për t'u kapërcyer, përpara se të zhvillohet raundi i fundit i negociatave. E para nga pengesat e tilla është tarifa 100% e vendosur nga Kosova për mallrat e importuara nga Serbia. Ndërsa tarifat kanë çuar që Serbia të braktisë tryezën e bisedimeve, tarifa duhet të hiqet tërësisht, ose të pezullohet përkohësisht, derisa Serbia të sinjalizojë një ndryshim në sjelljen e saj karshi anëtarësimit dhe pjesëmarrjes së Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Pengesa e dytë, e cila është e brendshme, është përcaktimi i politikës apo platformës negociuese të Kosovës drejt Serbisë në raundin e fundit të negociatave. Deri më tani, Kosova nuk ka

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty.

arritur të prodhojë një politikë të zbatueshme dhe unifikuese ndaj Serbisë për raundin e fundit të negociatave. Kosova duhet sa më parë të unifikojë qëndrimet e aktorëve politik vendor në një platformë kombëtare mbipartizane me të cilën do t'i qasej raundit final të negociatave me Serbinë.

VIII. Përfundimet

1. KSBE dhe më vonë OSBE u shfaqën si rezultat i shfrytëzimit të momentumit të krijuar si rezultat i përafrimit të marrëdhënieve midis fuqive kryesore që dominuan botën pas luftës së dytë botërore. Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara e kuptuan që loja që po luanin "Unë fitoj – Ti humb" do të qonte në rezultat zero derisa ato pothuajse aktivizuan arsenalin e tyre të vërtetë gjatë Krizës së Raketave Kubane në 1969. Kjo gjë do të shkaktonte vetëm shkatërrim, dhe mënyra më e mirë për të shmangur konfrontime të ngjashme në të ardhmen është diskutimi dhe bashkëpunimi me njëri-tjetrin për çështje të sigurisë dhe interesave të tjera të përbashkëta.
2. KSBE miratoi Aktin Final të Helsinkit, i cili edhe pse nuk është një traktat në kuptimin tradicional, "dekalogu" ose dhjetë parime të përfshira në të, konsiderohen si e drejtë ndërkombëtare zakonore, pra, e detyrueshme për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.
3. KSBE është shndërruar në OSBE-në e ditëve të sotme, e cila nga ana e saj është pozicionuar si një organizatë unike ndërkombëtare që merret me çështje që lidhen me sigurinë dhe bashkëpunimin; parandalimin dhe monitorimin e konflikteve; ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë në vendet pas konfliktit; promovimin dhe monitorimin e të drejtave të njeriut.
4. Siçu theksua, ekzistojnë tre arsye kryesore se pse anëtarësimi në OSBE është i rëndësishëm në kontekstin e Kosovës. Së pari, fitimi i anëtarësimit në OSBE do të konsolidonte pavarësinë e Kosovës dhe integrimin e saj në bashkësinë ndërkombëtare. Së dyti, Kosova do të jetë në gjendje të kontribuojë në organizatën dhe misionin e saj, bazuar në përvojën e saj unike. Dhe së fundi, anëtarësimi në

OSBE do t'i mundësonte Kosovës të mbrojë edhe më tej të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave kombëtare.

5. Sfida kryesore për t'u bërë një shtet anëtar në OSBE është konsensusi i detyrueshëm unanim midis 57 shteteve. Në rastin e Kosovës, mund të dallohen tre grupe të vendeve që potencialisht do të refuzonin ofertën e pranimit të Kosovës. Grupi i parë është Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, për shkak të kontekstit politik midis palëve. Grupi i dytë përbëhet nga vendet anëtare jo-njohëse të Bashkimit Evropian, kryesisht Spanja dhe Rumania. Dhe grupi i tretë që ka të ngjarë të kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës janë ish-Republikat Sovjetike për shkak të aleancës së tyre me Rusinë, dhe rrjedhimisht me Serbinë.
6. Duke marrë parasysh situatën unike politike të Kosovës si rezultat i Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, dhe marrëdhënies komplekse me Serbinë, vështirë që ndonjë përvojë e mëparshme e vendeve të tjera të mund të ishte e zbatueshme për Kosovën. Një përjashtim minimal do të mund të ishte rasti i Maqedonisë së Veriut.
7. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka qenë thelbësor në ndërtimin e institucioneve dhe përgatitjen e forcave të para moderne të policisë në Kosovë dhe autoriteteve gjyqësore dhe administratës civile pas luftës në Kosovë në 1999.
8. Misioni i OSBE-së në Kosovë ka qenë thelbësor në ndërtimin e kapaciteteve, krijimin dhe mbështetjen e shoqërisë civile, partive politike dhe organizatave të mediave në Kosovë pas luftës në Kosovë në 1999.
9. Misioni i OSBE-së në Kosovë po kontribuon edhe sot e kësaj dite në Kosovë, në veçanti në lidhje me të drejtat e pakicave kombëtare, monitorimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në rajone të caktuara të Kosovës të banuara me pakica kombëtare.
10. Kosova është në gjendje dhe e gatshme të zbatojë detyrimet dhe angazhimet që rrjedhin nga pranimi në OSBE dhe miratimi i Aktit Final të Helsinkit dhe Kartës së Parisit për një Evropë të Re të OSBE-së.

11. Këshilli i Ministrave i OSBE-së është organi përgjegjës vendimmarrës për pranimin e shteteve të reja pjesëmarrëse brenda OSBE-së dhe mund ta bëjë këtë me konsensusin e të gjitha shteteve pjesëmarrëse.

IX. Rekomandime

1. Kosova duhet të angazhohet me Misionin e OSBE-së në Kosovë me qëllim që të shprehë gatishmërinë dhe interesin e saj për pranim në OSBE dhe të kërkojë ndihmën e mekanizmave të OSBE-së në këtë proces.
2. Kosova duhet të arrijë një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obligative me Serbinë, e cila do të zhbllokojë perspektivën ndërkombëtare për Kosovën, përfshirë procesin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, përfshirë OSBE-në.
3. Kosova duhet të punojë me aleatët e saj, në veçanti SHBA-në, dhe vendet anëtare të BE-së për të mbështetur kërkesën e saj për pranim në OSBE dhe për të ndihmuar Kosovën të krijojë konsensus midis shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.
4. Kosova duhet të kërkojë mbështetjen e aleatëve të saj, në veçanti nga SHBA dhe vendet anëtare të BE-së, për angazhimin e mekanizmit të votimit “konsensusi minus një” në rast se Kosova nuk arrin një marrëveshje përfundimtare ligjërish obligative me Serbinë.
5. Kosova duhet të përgatisë kërkesën e saj për anëtarësim, së bashku me një arsyetim të hollësishëm se si pranimi në OSBE do të ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e pakicave kombëtare.
6. Për shkak të situatës së veçantë politike të Kosovës është e vështirë të nxjerrësh një paralelizëm midis pranimit të vendeve të tjera të ish-Jugosllavisë në OSBE dhe Kosovës. Prandaj, Kosova duhet të krijojë rrugën e saj të pavarur për t'u bërë një shtet anëtar i OSBE-së dhe të mos përpiqet të ilustrojë gjendjen e saj në rastet e mëparshme të anëtarësimit.

7. Në kërkesën e saj për pranim në OSBE, Kosova duhet të miratojë Aktin Final të Helsinkit, Kartën e Parisit për një Evropë të Re dhe dokumente të tjera OSBE-së, dhe të angazhohet për përmbushjen e detyrimeve që përmbahen në këto dokumente.

